

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit <b>KM-MIT</b>	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. <b>244/19</b>
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages <b>1</b>	Data : Datum : Date : <b>19.04.19</b>
PRISHTINE/A	



REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit <b>01</b>	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. <b>4199</b>
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages <b>01</b>	Data : Datum : Date : <b>23.04.19</b>

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit  
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta  
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

### VENDIM

**I. Aprovohet** kërkesa nr.2053 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus NTSH "Beni Reisen" me seli në Podujevë për marrjen e nisjes në relacionin Podujevë - Prishtinë dhe anasjelltas me nisje (06:20 - 07:50).

### Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus NTSH "Beni Reisen" me seli në Podujevë , ka plotësuar kushtet ligjore për

ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjes në relacionin Podujevë - Prishtinë dhe anasjelltas me nisje (06:20 - 07:50).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

### Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.